

V E N D I M
Nr. 162, datë 13.4.2000

**PËR SHPËRNDARJEN E VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE TË SHOQËRISË
“UNIVERSI”, SH.P.K. NË ADMINISTRIM, PËR MBYLLJEN E PROCESIT TË
ADMINISTRIMIT DHE PËR KALIMIN E DOKUMENTACIONIT FINANCIAR ORGANIT
TË HETIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 6, të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, dhe të neneve 3, 4 e 8, pika 3, të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave:

V E N D O S I:

1. Fillimin e procesit të shpërndarjes së vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Universi”, sh.p.k. në administrim, në bazë të të ardhurave financiare, të grumbulluara nga shitja e aseteve në ankandin publik.

2. Shuma e detyrimit të mbetur që shoqëria “Universi” sh.p.k., në administrim ka ndaj kreditorëve është 242 469 153 lekë.

Të ardhurat financiare për shpërndarje, të grumbulluara nga shitja e aseteve dhe ato gjendje të depozituara në bankë kapin shumën 96 000 000 lekë.

Koeficienti i kthimit të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Universi” sh.p.k. në administrim, për të gjithë kreditorët është: 0.40 ose 40 për qind.

3. Ngarkohet Banka e Kursimeve me shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Universi” sh.p.k., në administrim.

Shpenzimet për shërbimet që do të kryhen në sportelet e bankës së Kursimeve të përballohen nga zëri “Shpenzime” në buxhetin për vitin 2000 të Grupit të Mbikëqyrjes.

4. Dokumentacioni i ekspertimit kontabël dhe i administrimit të shoqërisë “Universi” sh.p.k. në administrim, t’i dorëzohet organit të hetimit.

5. Ngarkohen Banka e Kursimeve, Grupi i Mbikëqyrjes dhe administratori i shoqërisë “Universi” sh.p.k. në administrim, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta